

VENDIM
Nr.898, datë 11.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË MALIQ, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Maliq, që qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Maliq, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.12, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Maliq, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Maliq		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
6-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
27,29	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
30-25,566-572,	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
18-26	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
239-254	Shërbim funeral	Në pronësi
3,140-154,155-159,255,257-272,274-282,285,286,288-291,295-304,313-317,320-323,335-409,416-470,480-485,536,564,584,586,592-898,	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, troje të zëna) dhe shërbime publike	Në pronësi
52-72,5,29,94-102,104-106,287,497-501,505,507,510-523,525,527-	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

530,538,539,541,546,555,556,576,578,		
256,273,283,284,292,293,294,308-312,318,319,324-334,410-415,471-479,486-496,502-504,506,508-509,524,526,531-535,537,540,542-545,547-551,553-554,557-563,565,573,577,579-583,585,587,588,589-591,	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdo lloji	Në përdorim
160,162,163,165,167,169,171,173,175,176,178	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
899,	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
900-912	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
161,164,166,168,170,172,174,177	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive)	Në pronësi